



small
arms
survey

ARMËT DHE
TREGJET

Shënim studimor

NR. 6 • PËRDITËSUAR NË JANAR 2012

Shpërthimet e paplanifikuara në depot e municioneve

Vëmendje e konsiderueshme u është kushtuar kërcënimeve që paraqesin përhapja dhe keqpërdorimi i armëve të vogla dhe të lehta, por shumë pak dihet mbi rreziqet që përmbajnë municionet e keqmagazinuara ose të trajtuara pa kujdes.¹ Një shpërthim i vetëm i paplanifikuar në një depo municionesh mund të marrë dhjetëra jetë, të plagosë me qindra dhe të zhvendosë mijëra të tjerë.² Dëmet në infrastrukturë mund të jenë të mëdha, duke mbuluar shumë kilometra katrorë. Përveç

kësaj, humbja e aktivitetit ekonomik mund të tejkalojë dhjetëra milionë dollarë dhe të ketë pasoja afatgjata për jetesën dhe mjedisin.³

Shpërthimet e paplanifikuara në depot e municioneve (Unplanned Explosions at Munitions Sites—UEMS) janë një problem global. Që prej vitit 1998, incidente të kësaj natyre janë raportuar në më shumë se një të tretën e vendeve anëtare të OKB-së dhe në çdo kontinent përveç Australisë dhe Antarktidës (shih Tabelën 1). Ato kanë ndodhur

Tabela 1 **Numri i raportuar i shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve sipas rajonit, nën-rajonit dhe shteteve anëtare të OKB-së, janar 1998–tetor 2011***

Shpërndarja gjeografike		Incidenca e shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve		Numri i ngjarjeve sipas shtetit raportues
Rajoni ^a	Nën-rajoni (numri i shteteve anëtare të OKB-së)	Numri i shteteve anëtare të OKB-së që raportojnë shpërthime të paplanifikuara në depot e municioneve	Numri i ngjarjeve	
Afrika	Afrika Lindore (17)	4	14	Mozambiku (9); Tanzania (3); Kenia (1); Somalia (1)
	Afrika Qendrore (9)	3	8	Republika e Kongos (4); Republika Demokratike e Kongos (3); Angola (1)
	Afrika e Veriut (7)	4	7	Libia (2); Sudani (2); Sudani i Jugut ^b (2); Egjipti (1)
	Afrika Jugore (5)	0	0	Asnjë ngjarje e regjistruar
	Afrika Perëndimore (16)	5	9	Nigeria (3); Bregu i Fildishtë (2); Guineja (2); Guineja-Bisau (1); Sierra Leone (1)
Amerika	Karaibet (13)	1	1	Kuba (1)
	Amerika Qendrore (8)	4	6	Meksika (3); Guatemala (1); Nikaragua (1); Salvadori (1)
	Amerika e Veriut (2)	1	10	Shtetet e Bashkuara (10)
	Amerika e Jugut (12)	8	16	Ekuadori (6); Kolumbia (3); Brazili (2); Guajana (1); Kili (1); Paraguai (1); Peruja (1); Venezuela (1)
Azia	Azia Qendrore (5)	4	10	Kazakistani (6); Uzbekistani (2); Takhikistani (1); Turkmenistani (1)
	Azia Lindore (5)	3	14	Kina ^c (10); Koreja e Veriut (3); Koreja e Jugut (1)
	Azia Jugore (9)	5	58	Afganistani (18); India (18); Sri Lanka (9); Irani (8); Pakistani (5)
	Azia Juglindore (11)	6	22	Tailanda (6); Vietnami (5); Filipinet (4); Kamboxhia (4); Indonezia (2); Laosi (1)
	Azia Perëndimore (17)	9	35	Iraku (15); Jemeni (6); Libani (4); Turqia (3); Gjeorgjia (2); Izraeli ^d (2); Kuvajti (1); Qiproja (1); Siria (1)
Evropa	Evropa Lindore (10)	6	57	Federata Ruse (40); Ukraina (10); Bullgaria (3); Rumania (2); Polonia (1); Sllovakia (1)
	Evropa e Veriut (10)	2	3	Mbretëria e Bashkuar (2); Danimarka (1)
	Evropa Jugore (14)	8	21	Serbia (8); Shqipëria (5); Bosnja e Hercegovina (2); Mali i Zi (2); Italia (1); Kroacia (1); Sllovenia (1); Spanja (1)
	Evropa Perëndimore (9)	3	11	Gjermania (7); Franca (3); Belgjika (1)
Totali	193	76	302	

Shënime:

* Sipas Divizionit të Statistikave të Kombeve të Bashkuara (rishikuar në korrik 2011).

a. Nuk ka shpërthime të raportuara në asnjë prej 14 vendeve anëtare të OKB-së në Oqeani.

b. Dy incidentet e regjistruara në Sudanin e Jugut ndodhën në Juba, në 2005 dhe 2007, përpara se Sudani i Jugut të bëhej shtet anëtar i OKB-së (14 korrik 2011) dhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes Gjithpërfshirëse të Paqes (9 janar 2005).


c. Shifra për Kinën përfshin tetë incidente të regjistruara në Tajvan, të cilin OKB-ja e ka njohur si provincë të Kinës që nga viti 1971.

d. Dy incidentet në fjalë ndodhën në territoret palestineze.

Burimet: UNSD (2011); Wilkinson (2011); Zahaczewsky (2011); Small Arms Survey Baza e të dhënave e shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve

Figura 1 **Numri i regjistruar i shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve sipas vitit, janar 1998–tetor 2011***

Numri i shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve



Burimet: Wilkinson (2011); Zahaczewsky (2011); Small Arms Survey Baza e të dhënave e shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve

rregullisht, me një mesatare prej tre të tilla çdo dy muaj për periudhën dhjetëvjeçare nga viti 1998 deri në 2007 (shih Figurën 1). Baza e të dhënave Small Arms Survey për shpërthimet e paplanifikuara në depot e municioneve⁴ zbulon se frekuenca e tyre është rritur në vitet e fundit në më shumë se një në çdo dy javë. Është e paqartë nëse problemi është duke u përkeqësuar apo është duke u përmirësuar raportimi i incidenteve. Ajo që është e qartë është se frekuenca e shpërthimeve nuk po ulet, pavarësisht përpjekjeve për të trajtuar shkaqet e tyre.⁵

Ka shkaqe të shumta për shpërthimet e paplanifikuara në depot e municioneve. Shumica e tyre ka lidhje me mungesën

e njohurisë teknike dhe të kushtimit të vëmendjes së mjaftueshme ndaj standardeve të sigurisë.⁶ Praktikrat e këqija të magazinimit dhe infrastruktura e dobët janë gjithashtu shkaqe të mëdha për shpërthimet e paplanifikuara në depot e municioneve dhe kontribuojnë në sfidat e sigurisë që kanë lidhje me to.⁷ Shkaqe të tjera të shpeshta përfshijnë pakujdesinë gjatë trajtimit dhe gjatë transportit të municioneve. Pavarësisht kësaj, për pothuajse një të tretën e shpërthimeve të raportuara, nuk është regjistruar ende shkaku (shih Tabelën 2).

Shtetet që tregojnë vullnet të fortë politik për trajtimin e shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve,

shpesh me asistencë ndërkombëtare, mund t'i parandalojnë shpërthimet e paplanifikuara ose mund t'i lehtësojnë pasojat e tyre. Një numër organizatash rajonale kanë zhvilluar udhëzime mbi praktikrat më të mira në lidhje me sigurinë fizike dhe menaxhimin e rezervave. (Physical Security and Stockpile Management—PSSM)⁸ Koalicionet ad-hoc të vendeve të gatshme, siç janë nëntë vendet në Evropën Juglindore që përbëjnë Nismën e Përfaqësjes Rajonale për Reduktimin e Rezervave (The Regional Approach to Stockpile Reduction (RASR) Initiative), theksojnë rëndësinë që kontribuojnë shtetet për sigurinë fizike dhe menaxhimin e rezervave.⁹ Donatorët ndërkombëtarë punojnë në mënyrë bila-

Tabela 2 **Shkaqet e raportuara të shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve, janar 1998–tetor 2011***

Kategoria	Shkaqet	Numri i ngjarjeve	% e të gjitha shkaqeve	% e shkaqeve të njohura
1. Përkeqësimi i kushteve fizike ose kimike të municioneve dhe eksplozivëve	Ndezja spontane e lëndëve djegëse	18	6,0%	8,4%
2. Praktikrat dhe infrastruktura e pasigurt e magazinimit	Defektet elektrike	12	4,0%	5,6%
	Zjarri**	46	15,2%	21,4%
	Temperatura e lartë	11	3,6%	5,1%
	Rrufetë	15	5,0%	7,0%
	Tjetër	3	1,0%	1,4%
3. Praktikrat e pasigurta të trajtimit dhe transportit	Gjatë çmilitarizimit ose asgjësimit të municioneve shpërthyes	36	11,9%	16,7%
	Trajtimi/pakujdesia	52	17,2%	24,2%
4. Kushtet e këqija të sigurisë	Siguria/sabotimi	22	7,3%	10,2%
5. Shkaqe të panjohura	Nuk njihen	87	28,8%	
Totali		302	100,0%	100,0%

Shënime:

* Kategoritë dhe shkaqet në këtë tabelë janë në procesin e rishikimit dhe përditësimit.

** Shumë nga këto zjarre mund të jenë shkaktuar nga ndezja spontane e lëndëve djegëse.

Burimet: Wilkinson (2011); Zahaczewsky (2011); Small Arms Survey Baza e të dhënave e shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve



Një zjarr u raportua si shkak i një shpërthimi të një depoje municioni artilerie të ushtrisë venezuelase, duke vrarë një person dhe duke detyruar evakuimin e 10 000 banorëve nga zonat përreth. Marakaj, Venezuelë. Janar 2011.
© Gerard Aponte/Reuters

terale dhe përmes organizatave rajonale kanë asistuar me dhjetëra qeveri në asgjësimin e sigurt të stoqeve të tepërta të municioneve dhe në sigurimin e materialeve të mbetura në kushte të sigurta.¹⁰

Disa zgjidhje janë të kushtueshme për t'u implementuar dhe mund të kërkojnë asistencë të jashtme, por shumë të tilla mund të ndërmerren në mënyrë të njëanshme dhe me investime modeste. Disa depo municionesh mund të jetë e nevojshme të mbyllen dhe municionet e tyre të zhvendosen në një vendndodhje tjetër me kosto të madhe. Mund të jetë e nevojshme të ndërtohen nga fillimi depo të reja, që përfshijnë parimet sasi–distanca dhe veçoritë e sigurisë. Megjithatë, pa qenë e nevojshme që të arrihen standarde moderne magazinimi, një numër masash pragmatike mund të zgjidhin rrezikun e menjëhershëm të shpërthimeve të

paplanifikuara. Siç përshkruhet në kartat e praktikave më të mira të RASR-së për sigurinë fizike dhe menaxhimin e rezervave (shih më poshtë),¹¹ shtetet mund të arrijnë vetë rezultate pozitive duke ndërmarrë disa hapa fillestarë të efektshëm dhe të pakushtueshëm. Këto përfshijnë instalimin e dyerve dhe kyçeve të përshtatshme, përdorimin e gardheve dhe pengesave të mjaftueshme, vendosjen e tabelave për të paralajmëruar dhe informuar, organizimin e rezervave në stiva, garantimin që korridoret e kalimit të mos jenë të bllokuara. ■

Shënime

- 1 Në këtë *Shënim studimor*, si në praktikën e përditshme, termi «municione» u referohet armëve, municioneve dhe pajisjeve ushtarake; megjithatë, termi mund të përdoret edhe për t'iu referuar ekskluzivisht rundeve të plota të municioneve.

- 2 Numri i viktimave ndonjëherë ka qenë edhe më i madh. Në janar 2002, për shembull, një seri shpërthimesh në një depo ushtarake në periferitë e Lagosit në Nigeri, qyteti më i populluar i Afrikës Sub-Sahariene, rezultoi në më shumë se 1000 të vdekur, ku shumë prej tyre u mbytën në kanalet aty pranë në përpjekje për t'iu larguar zjarreve dhe shpërthimeve (MSIAC, 2002). Shih gjithashtu, USDoS (2010).
- 3 Pas një shpërthimi në Paracin të Serbisë, në vitin 2006, u raportua se një rrugë kryesore aksesi mbeti e bllokuar për 32 orë dhe pati humbje tregtare të llogaritura në 15 milionë EUR (19 milionë USD) (Parliamentary Forum, 2008). Ushtria serbe pas kësaj largoi më shumë se 130 000 pjesë municione të paplasura nga një perimetër prej 8 km² rreth zonës së kontaminuar (Jovanović, 2011).
- 4 Baza e të dhënave e shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve krijohet në bazë të listës së incidenteve të hartuar nga Adrian Wilkinson dhe George

Kartat e praktikave më të mira të RASR-së për sigurinë fizike dhe menaxhimin e rezervave:

<p>2 ♣</p> <p>DOORS</p> <p>♣ 2</p>  <ul style="list-style-type: none"> • Door made of steel (or 4.5 cm wood with 12 gauge steel plate) • Frame anchored to building at 8 places • Hinges welded to prevent pin removal • Marked with UN Fire Division symbol • Doors open OUTWARDS – cannot be rammed • Light gauge handles break off easily – cannot be used to pull off door • Door seam covered with metal strip – prevents lever from fitting inside <p>♣ 2</p>	<p>4 ♣</p> <p>SIGNS</p> <p>♣ 4</p>  <ul style="list-style-type: none"> • List forbidden items (cell phones, flame-producing items, etc.) • Identify restricted areas <p>♣ 4</p>	<p>5 ♣</p> <p>FENCES AND BARRIERS</p> <p>♣ 5</p>  <ul style="list-style-type: none"> • A barrier within a barrier • For Category I and II items barriers are WITHIN the installation boundaries • Clear zones with unimpeded visibility: <ul style="list-style-type: none"> • 4 m inside • 10 m outside <p>♣ 5</p>	<p>6 ♣</p> <p>LOCKS</p> <p>♣ 6</p>  <ul style="list-style-type: none"> • Must protect against manual manipulation (hammers, bars, etc.) for at least 15 minutes • Must protect against powered tools (drills, saws, etc.) for at least 5 minutes <p>♣ 6</p>
---	--	--	--

- Zahaczewsky (Wilkinson, 2011; Zahaczewsky, 2011); ajo do të bëhet e disponueshme në faqen e internetit të Small Arms Survey në fillim të vitit 2012.
- 5 Të rrezikuara janë edhe ambientet private. Baza e të dhënave e shpërthimeve të paplanifikuara në depot e municioneve (UEMS) kërkon të bëjë dallim mes ambienteve që janë ndërmarrje plotësisht shtetërore ose private nga ato që zotërohen nga shteti, por menaxhohen në mënyrë private.
 - 6 Vetëm ekspertët e trajnuar mund të kryejnë mbikëqyrje fizike rutinë dhe testim kimike gjatë ciklit të jetës së lëndëve djegëse, kapsollave ndezëse dhe pjesëve shpërthyes.
 - 7 Rezervat shtetërore të keqmenaxhuara lehtësojnë edhe korrupsionin për shkak të regjistrimit të paplotë dhe vjedhjes nga kriminelët dhe grupet e armatosura joshtetërore.
 - 8 Shih, për shembull, NATO (2010), OSCE (2008), RECSA (2005) dhe SEESAC (2007). Shih gjithashtu Standardet Ndërkombëtare të OKB-së për Kontrollin e Armëve të Vogla (CASA, n.d.) dhe Udhëzimet Teknike të Municioneve Ndërkombëtare të Zyrës së OKB-së për Çështjet e Çarmatimit (UNODA, n.d.; King, 2011, p. 4).
 - 9 Për më shumë informacion mbi Nismën e RASR-së të financuar nga SHBA-ja për Shqipërinë, Bosnjën e Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Rumaninë, Serbinë dhe Slloveninë, shih RASR-në (n.d.a).
 - 10 Praktikant më të mira shpesh përballen me sfida të papritura kur vihen në praktikë. Shih, për shembull, King (2011).
 - 11 Shih RASR (n.d.b).

Referencat

- CASA (United Nations Coordinating Action on Small Arms). n.d. 'CASA Project on International Small Arms Control Standards (ISACS).' <<http://www.un-casa-isacs.org/isacs/Welcom.html>>
- Jovanović, Dragan. 2011. 'ERW in the Republic of Serbia.' *Journal of ERW and Mine Action*, Vol. 15, No. 1, pp. 58–61. <<http://maic.jmu.edu/journal/15.1/notes/jovanovic/jovanovic.htm>>
- King, Benjamin, ed. 2011. *Safer Stockpiles: Practitioners' Experiences with Physical Security and Stockpile Management (PSSM) Assistance Programmes*. Occasional Paper No. 27. Geneva: Small Arms Survey.
- MSIAC (Munitions Safety Information Analysis Center). 2002. *MSIAC Newsletter*. 1st Quarter.
- NATO (North Atlantic Treaty Organization). 2010. *Manual of NATO Safety Principles for the Storage of Military Ammunition and Explosives*. Brussels: NATO. <<http://www.rasrinitiative.org/pdfs/AASTP-1-Ed1-Chge-3-Public-Release-110810.pdf>>

- OSCE (Organization for Security and Co-operation in Europe). 2008. *Handbook of Best Practices on Conventional Ammunition*. Vienna: OSCE. <<http://www.osce.org/files/documents/5/5/33371.pdf>>
- Parliamentary Forum (Parliamentary Forum on Small Arms and Light Weapons). 2008. 'Side Event on Parliamentary Oversight of Stockpile Management of Conventional Ammunition, Held during the United Nation Third Biannual meeting of States on the Program of Action on SALW on Monday 14 July [sic].' <http://www.parliamentaryforum.org/joomla/images/stories/report_ammunition_stockpile_seminar_.pdf>
- RASR (Regional Approach to Stockpile Reduction). n.d.a. Website. <<http://www.rasrinitiative.org/>>
- n.d.b. 'PSSM Best Practice Cards (English version).' <<http://www.rasrinitiative.org/resources-PSSM-identification-cards.php>>
- RECSA (Regional Centre on Small Arms and Light Weapons). 2005. *Best Practice Guidelines for the Implementation of the Nairobi Declaration and the Nairobi Protocol on Small Arms and Light Weapons*. Nairobi: RECSA. <<http://www.recsasec.org/pdf/Best%20Practice%20Guidelines%20Book.pdf>>
- SEESAC (South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons). 2007. *Ammunition and Explosives Storage and Safety*. RMD5/G 05.40, 5th edn. Belgrade: SEESAC. <[http://www.seesac.org/uploads/rmdsg/RMD5-G_05.40RMD5_05.40_Ammunition_Storage_\(Edition_5\).pdf](http://www.seesac.org/uploads/rmdsg/RMD5-G_05.40RMD5_05.40_Ammunition_Storage_(Edition_5).pdf)>
- UNODA (United Nations Office for Disarmament Affairs). n.d. 'International Ammunition Technical Guidelines.' <<http://www.un.org/disarmament/convarms/Ammunition/IATG/>>
- UNSD (United Nations Statistical Division). 2011. 'Composition of Macro Geographical (Continental) Regions, Geographical Sub-regions, and Selected Economic and Other Groupings.' Accessed July 2011. <<http://unstats.un.org/unsd/methods/m49/m49regin.htm>>
- USDoS (United States Department of State). 2010. 'Dangerous Depots: The Growing Humanitarian Problem Posed by Aging and Poorly Maintained Munitions Storage Sites.' Washington, DC: Bureau of Political-Military Affairs. 19 May. <<http://www.state.gov/t/pm/rls/fs/141988.htm>>
- Wilkinson, Adrian. 2011. 'The Threat from Explosives Events in Ammunition Storage Areas.' No. 2. Kent: Explosive Capabilities Limited. May.
- Zahaczewsky, George. 2011. 'Major Ammunition Accidents: Compilation of Events from 1917 to 2011.' Unpublished document.

Për informacion shtesë mbi shpërthimet e paplanifikuara në depot e municioneve, ju lutemi vizitoni:
 <www.smallarmssurvey.org/?uems> dhe
 <www.smallarmssurvey.org/?pssm>

Rreth Small Arms Survey

Small Arms Survey shërben si burimi kryesor ndërkombëtar i informacionit publik për të gjitha çështjet që lidhen me armët e vogla dhe dhunën e armatosur, si edhe si qendër burimore për qeveritë, politikëbërësit, studiuesit dhe aktivistët. Projekti Small Arms Survey i shpërndan konstatimet e tij përmes dokumenteve të herëpashershme, përmbledhjeve të botimeve, dokumenteve të punës, raporteve speciale, librave dhe botimit të tij kryesor të përvitshëm, *Small Arms Survey*.

Projekti ka një staf ndërkombëtar me ekspertizë në studime të sigurisë, shkencë politike, politikë publike ndërkombëtare, juridik, ekonomi, studime zhvillimi, zgjidhje konfliktesh, sociologji dhe kriminologji, dhe bashkëpunon ngushtë me një rrjet ndërkombëtar studiuesish dhe partnerësh.

Small Arms Survey është projekt i Institutit Studimor të Studimeve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit (Graduate Institute of International and Development Studies) në Gjenevë. Për më shumë informacion, shih www.smallarmssurvey.org.

Botimi i parë: maj 2011

Ky botim: janar 2012

Kreditet

Autorët: Eric G. Berman, Pierre Gobinet dhe Pilar Reina

Detajet e kontaktit

Small Arms Survey
 Graduate Institute of International and Development Studies
 47 Avenue Blanc, 1202 Gjenevë
 Zvicër

t +41 22 908 5777

f +41 22 732 2738



RASR
 The Regional Approach
 to Stockpile Reduction

Për më shumë informacion, shih:
www.rasrinitiative.org